



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 15, datë 16.10.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“NDËRTIMI DHE ADMINISTRIMI I IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE  
URBANE TË QARKUT FIER DHE PRODHIMIN E ENERGJISË”, ME VENDNDODHJE  
NË BASHKINË FIER

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi dhe administrimi i Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Fier.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**DAMIAN GJIKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

